

Paqëndrueshmeria Historike e Sistemit Politik në Shqipëri

PhD C. Xhensila Pine

Qendra e Studimeve Albanologjike, Albania

Abstrakt

Ky artikull është një përpjekje për të hedhur dritë mbi atë ç'ka vërtet ka ndodhur me sistemet politike ndër vite, e atë që vërtet ndryshoi te to dhe ndërmjet tyre si dhe ç'ka ngeli e njëjtë ashtu sikundër shumë kush e mendon edhe sot.

Në studimet historiko-juridike shqiptare mungon një botim bashkërisht i aktet themelore të rregullimit të sistemit politik (statute, kushtetuta). Krahas kësaj mungon dhe një histori e vetë sistemit politik, e jetës së parlamentit. Ky shkrim mbushë një boshllëk në kuadër të kësaj zbrazëtie të madhe të shumanshme. Qëllimi i këtij artikulli, është që të ndriçojë, në pikëpamjen juridike-historike, gjendjen dhe evolucionin e sistemeve politike në Shqipëri.

Të dhënat bazë të evolucionit të historisë politike të Shqipërisë, janë mbledhur e evidentuar tërësisht dhe paraqiten si pjesë e këtij shkrimi.

Megjithëse një histori e caktimit të kufijve dhe e zhvillimit të sistemit politik në Shqipëri nuk është shkruar ende, dihet se rruga që ky ka përshkruar gjatë kësaj periudhe shteti shqiptar është me shumë të papritura e ndërlikime. Ndryshimet në këtë sistem kanë qenë të shpeshta e kanë mbetur për një kohë të gjatë të fshehta. Shumë fakte historikë mbeten të pashqiptuar.

Tronditjet e herpashershme në sistemin politik, përmbysjet, marrja e pushtetit me dhunë, revolucionet popullore, luhatjet dhe pasiguritë, zigzag-et, si dhe shumë paqartësi të tjera, janë shkak themelor që Shqipëria është akoma duke kërkuar rrugën e saj.

Pikërisht ky rrotullim e alternim i çuditshëm i formave kontradiktore të qeverimit; është një prej shkaqeve jo vetëm të mosmarrëveshjeve shkencore dhe politike për vlerësimin e së shkuarës, jo vetëm të varfërimit të historisë politike të vendit, por dhe të paqëndrueshmërisë së sistemit politik në vend dhe të zgjatjes së tranzicionit.

Paqëndrueshmëria historike e sistemit politik në Shqipëri është një nga shkaqet themelore të destabilizimit të herëpashershëm të jetës së vendit.

Megjithëse një histori e caktimit të kufijve dhe e zhvillimit të sistemit politik në Shqipëri nuk është shkruar ende, dihet se rruga që ky ka përshkruar gjatë kësaj periudhe shteti shqiptar është

me shumë të papritura e ndërlikime. Ndryshimet në këtë sistem kanë qenë të shpeshta e kanë mbetur për një kohë të gjatë të fshehta. Shumë fakte historikë mbeten të pashqiptuar.

Paqartësia politike dhe formale-juridike në përkufizimin e formës së sistemit politik; e shprehur edhe në ndërtimin e hierarkisë shtetërore dhe të raporteve midis institucioneve; është burim i autoritarizmit dhe shkak i vonimit të tranzicionit politik tashmë zyrtarisht të stërzgjatur⁶³. Problemi është përkufizuar si çështje e historisë politike të vendit, me një ndikim të fortë në jetën e sotme. Tronditjet e herpashershme në sistemin politik, përmbysjet, marrja e pushtetit me dhunë, revolucionet popullore, luhatjet dhe pasiguritë, zigzag-et, si dhe shumë paqartësi të tjera, janë shkak themelor që Shqipëria është duke rezultuar ndër vendet e prapambetura në Europë, siç ishte në ditën e krijimit.

Shqipëria u shpall “e mosvarme” më 1912. Në historinë e Shqipërisë qeveria e Ismail Qemalit, që mori në dorë fatet e vendit, cilësohet “qeveri kombëtare”. Por burimet tregojnë se njohja ndërkombëtare e Shqipërisë si shtet i pavarur u bë me kushte. Një prej këtyre kushteve ishte që shteti i ri shqiptar të ishte monarki e trashëgueshme. Shqipëria do të ishte një “principatë autonome neutrale e sovrane”. Ndërkohë, parashikohej që vendi të ishte “nën një kontroll ndërkombëtar shumëvjeçar”.

Një nga arsytet e dorëheqjes së pakomentuar të Ismail Qemalit dhe e largimit enigmatik të tij drejt Italisë ishte akuza që ministrat e qeverisë së vet i bënë se e kishte shpallur Shqipërinë shtet të pavarur për t’u fronëzuar vetë si mbret sovran i saj. Një akuzë të ngjashme do ta përsëriste gjashtë dekada më vonë edhe Eqerem bej Vlora, në kujtimet e tij të botuara në Gjermani, në kontekstin që kurora nuk mund të trashëgohej në linjën e kushëririt të tij Ismail Qemali, por të një dinastie tjetër të bejlerëve të Kaninës, të përfaqësuar nga ai vetë.

Që njohja ndërkombëtare e Shqipërisë pati si kusht krijimin e një “shteti me kurorë”, këtë e tregojnë dhe vendimet e Konferencës së Ambasadorëve (1913), konferencë e cila statusin e shtetit shqiptar e përcaktoi ndërmjet kundërthëniesh të forta parimore: si një shtet edhe autonom edhe sovran, edhe sovran edhe neutral, edhe me pavarësi edhe nën kontroll ndërkombëtar. Ishte pikërisht kjo konferencë që e shprehu vendimin e saj për sistemin politik të Shqipërisë duke paracaktuar kthimin e saj në “principatë të trashëgueshme”, që do të thoshte “shtet me kurorë të kufizuar” dhe që parakuptonte një lidhje organike froni me një nga monarkitë e mëdha europiane, e cila do të ushtronte autoritetin e kurorës dhe do të trashëgonte fronin. Në këtë

⁶³. Sh. Sinani, “*Një parlament që vetëtiu*”, hyrje në “Këshilli I Kombëtar”, Tiranë 2000, f. 3-16.

periudhë nisi ajo që është quajtur “parada e princërve”: dhjetëra kandidatura u shfaqën menjëherë, prej dyerve të mëdha perandorake e sulltanore.

Pas largimit të Ismail Qemalit, Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve shpalli “Statutin organik të Shqipërisë”, një dokument që e kthente Shqipërinë në një lloj principate të tipi feudal, të drejtuar nga një princ i huaj me fuqi të plota.

Gjatë gjashtë muajve të sundimit të Princ Wied-it, forma monarkike e regjimit u reduktua më tej, deri në nivelin më të ulët, në atë të principatës, që nënkuptonte kufizimin e pamëshirshëm të sovranitetit të jashtëm dhe të brendshëm të vendit dhe theksonte vazhdimësinë e pakufizuar të protektoratit ndërkombëtar. Ishte pak a shumë e njëjta mënyrë sjelljeje ose më saktë një evokim i marrëdhënieve që Arbëri mesjetar kishte pasur me Mbretërinë e Napolit, të cilat, me përjashtim të një kohe të shkurtër të periudhës së qendresës antiosmane të Gjergj Kastriotit, kanë qenë ”marrëdhënie vasaliteti”.

Periudha e princ Wied-it shihet kryesisht si ksenokraci, por jo në thelbin e vet, si principatë e trashëgueshme. Slogani më i njohur për periudhën 1925-1938 është se Ahmet. Zogu u vetëshpall mbret, por nuk gjenden shpjegime pse parlamentarizmi i viteve 1920-1924 nuk arriti të kurorëzohej me shpalljen e republikës⁶⁴. Periudha e Fan Nolit karakterizohet si “demokraci e rrethuar”, por cili ishte sistemi politik që ai donte të ndërtonte?⁶⁵ Organizata politike e periudhës së luftës antifashiste Balli Kombëtar cilësohet vegël e pushtuesit, por nuk pohohet askund se kjo ishte një organizatë republikane dhe antimonarkike⁶⁶. Përkundër kësaj, askund nuk gjen shpjegim fakti që krahu nacionalçlirimtar e ruajti më gjatë aleancën me legalistët monarkistë. Në të vërtetë historia politike e sistemit në Shqipëri vërtitet midis dy fjalësh çelësa: midis legalitetit dhe ilegalitetit.

Mungojnë tërësisht studimet për republikën e çuditshme, në fakt një sistem politik autokratik, që projektoi e djathta në vitin 1994, me projektin e dështuar të Kushtetutës. Megjithatë, ai mbetet i pari referendum në të cilin populli vetë u ftua të vendosë për formën e shtetit,

⁶⁴ “*Ligjvënësit shqiptarë 1920-1995*”, botim i Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë 2005; f. 2-3.

⁶⁵. “Noli dhe miqtë e tij, që erdhën në pushtet me revolucionin e vitit 1924, përfaqësonin atë klasë shoqërore përparimtare, që kishte udhëhequr procesin e emancipimit kulturor e politik të kombit shqiptar në 50 vjetët e fundit. Si të tillë, ata vunë në rend të parë të programit të tyre ndarjen e Shqipërisë nga sistemi dhe ideologjia turkoshake e organizimit të shtetit. “Çrrënjësja e feudalizmit” si mënyrë të prodhuari, të menduari e të qeverisuri, ishte prioriteti kryesor i qeverisë së Nolit”.

⁶⁶. “*Unë, Ramiz Alia, dëshmoj për historinë*”, Tiranë 1994.

megjithëse rezultati i tij qe një dështim. Sa i takon referendumit të vitit 1998, si zgjidhje kompromisi që ishte, votim për pushtetin paralelisht me votimin për formën e qeverisjes, gjithashtu ka pasur vetëm analiza agjitative dhe të pathelluara, sidomos në pyetjen se si qytetari shqiptar ngatërrohet në votën për pushtet me votën për të ndërtuar një shtet me parime kushtetuese të qendrueshme.

Një kalendar i sistemit politik⁶⁷:

1.1. “Qeveria kombëtare” e Ismail Qemalit, e kushtëzuar në njohjen e saj ndërkombëtarisht si “Mbretëria e Shqipërisë”, “Monarkia e Parë”, 1912-1913 (kjo do të bëhej një nga shkaqet e largimit dramatik dhe të zhgënjyer të plakut të Vlorës nga ai vend që vetë e kishte shpallur të pavarur).

1.2. Administrata ndërkombëtare e Princ Vidit, e njohur ndërkombëtarisht si “principatë e trashëgueshme”, një monarki me funksione të rrudhura, që mund të cilësohet edhe “protektorati i parë” monarkik, 1913-1914.

1.3. Qeveria kalimtare periudhës së luftës, e dalë prej një pashallëku, alternativiste e qeverisë kombëtare, me regjencë në krye, e njohur ndërkombëtarisht (në Konferencën e Paqes - 1918) si “regjenca e parë” - 1914-1920.

1.4. “Qeveria kombëtare” e dalë nga kongresi i Lushnjës, me një “pleqësi” në krye, që zëvendësoi “regjencën”; me zhvillim të suksesshëm të parlamentarizmit dhe me elementë të dukshëm të republikanizmit, por pa arritur deri në shpalljen e saj si formë qeverisjeje (formalisht “pleqësia” i përgjigjej “regjencës”) - 1920-1924.

1.5. “Qeveria rebele” e Fan Nolit, e vendosur pas fitores së revolucionit demokratik të qershorit (1924), me projekte për thellimin e republikanizmit dhe të parlamentarizmit, por me jetë të shkurtër, për shkak të restaurimit të pushtetit personal të Ahmet Zogut, i kthyer në atdhe me ndihmën e mbretërisë serbo-sllloveno-kroate dhe të mbetjeve të ushtrisë vrangeliste - 1924.

1.6. “Republika e parë” zogiste, e shpallur menjëherë pas kthimit të ish-kryetarit të qeverisë në pushtet, e karakterizuar nga një varfëria dhe formalizmi i jetës parlamentare, për shkak të politikës ostraciste që u ndoq ndaj kundërshtarëve politikë, të cilët u dëbuan nga atdheu - 1925-1928.

⁶⁷. Sh. Sinani, në: “Albania - a patrimony of European Values”, Tirana 2000; po ai, “Një Shqipëri tjetër”, Tiranë 2007, f. 370 e vijim.



A. Zogu kryeminister me disa nga ministrat e kabinetit

1.7. “Monarkia shqiptare”, e cilësuar “parlamentare”, por realisht absolute, sepse ishte e trashëgueshme, me mbret Zogun e parë. Kjo është periudha e shndërrimit të vendit në një territor ekstra-ballkanik (me sytë e fqinjëve), për shkak të traktateve të lidhura me Italinë, që konfirmonin së brendshmi përmbajtjen e akteve që Lidhja e Kombeve kishte miratuar në dëm të barazisë së Shqipërisë si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, duke njohur shprehimisht “të drejtën e Italisë për mbrojtjen e interesave të saj në Shqipëri” - 1928-1939.

1.8. “Protektorati i dytë monarkik”, i shprehur në bashkimin e Shqipërisë me Italinë, nën kurorën e mbretit Viktor Emanuel III dhe me një mëkëmbës të tij në Tiranë, i ngjashëm me mëkëmbësinë princërore të Vidit më 1914. Kjo është periudha e pushtimit të vendit nga ushtritë fashiste italiane 1939-1943. Kurora mbretërore iu dhurua mbretit të Savojës në këmbim të premtimit për krijimin e Shqipërisë shtetërore sipas kufijve të saj historikë.

1.9. “Regjenca e dytë”, e shpallur nominalisht me mbërritjen e ushtrive naziste dhe vendosjen e pushtetit të tyre - 1943-1944.



Regjencia shqiptare (1943-1944) ne nje mbledhje

1.10. “Qeveria demokratike” komuniste (fillimisht “komitet antifashist”), e deklaruar për qendrimet e veta antimonarkiste, e dalë nga një kongres i përfaqësuesve të brigadave partizane dhe të përkrahësve të tyre fitimtarë, mbajtur më 24 maj 1944 në Përmet.

1.11. “Republika Popullore” e Shqipërisë, “Republika e Dytë”, e shpallur pas thirrjes së një asambleje kushtetuese më 1945, me pjesëmarrjen e forcave komuniste dhe të një opozite modeste të tyre: 1946-1976; “republika popullore socialiste” e Shqipërisë, vazhdim i “republikës së dytë”, e kryesuar formalisht nga një “presidium”, analog me “pleqësinë” - 1976-1991.

1.12. “Republika e tretë” e Shqipërisë, e shpallur pas zgjedhjeve të para shumëpartiake, e sanksionuar nominalisht si “republikë parlamentare”, me institucion përfaqësimi presidentin - 1991-2005.

Disa mospërputhje midis formës së shpallur dhe funksionimit përmbajtësor të sistemit politik:

Periudha më e lulëzuar e parlamentarizmit në Shqipëri, që logjikisht do të nënkuptonte edhe republikanizmin, është ajo e viteve 1920-1924. Por në këtë periudhë nuk ekziston një republikë e shpallur.

Për herë të parë Shqipëria u shpall republikë pas kthimit të Ahmet Zogut e “rivendosjes së legalitetit” (1925). Por, me funksionin e kryetarit të republikës, Zogu përqendroi në një

institucion, në institucionin e kryesuar nga ai vetë, kompetenca autokratike me karakterin e një mbreti të kurorëzuar.

Deri në përfundimin e luftës antifashiste, hapur apo tërthorazi, forma e sistemit politik në Shqipëri vijoi me luhajtje të vogla e të përkohshme një rrugë monarkike. Shkaqet e kësaj vijimësie nuk janë studiuar.



Kuvendi i Shqiperise ne vitet 1970

Republikanizmi i periudhës komuniste mbylli kushtetutshmërisht dhe realisht këtë traditë historike nga më të paqartat. Por, megjithatë, republikën e premtuar nuk e realizoi. Në të vërtetë Kryetar i Shtetit ishte kreu i PPSH. Pushtetet kryesore ishin përqendruar totalitarisht tek ai. Në ditën e vdekjes së Enver Hoxhës Këshilli i Sigurimit i OKB-së mbajti minutën e heshtjes formale pikërisht duke iu referuar faktit që si udhëheqës partie ai kontrollonte tërësisht veprimtarinë e shtetit⁶⁸.

⁶⁸. “Luhajtja /ndodhi/ për shkak të mungesës së një regjimi të konsoliduar, republikë apo monarki. Regjimi me afatgjatë është republika e krijuar nga komunistët, e cila ishte më shumë një formë monarkie, po pa të drejtë trashëgimie”. P. Xhufi.

Në Dispozitat Kryesore Kushtetuese (1991) forma e regjimit të shpallur ishte republikë parlamentare. Pa qenë kushtetutë e plotë, këto dispozita bënë ndarjen e pushteteve. Por kjo nuk e pengoi autoritarizmin dhe autokracinë. Më 1994 një projekt-kushtetutë e refuzuar me referendum parashikonte edhe formalisht përqendrim të fortë pushtetesh në figurën e presidentit. Nga krahasimi i kompetencave të kryetarit të shtetit (republikës) në këtë projekt-kushtetutë me ato të Statutit të mbretërisë të vitit 1928 del se mbreti sovran kishte më pak kompetenca⁶⁹. U tentua një mbretëri e pashpallur. Problemi i formës së sistemit politik mbeti i hapur edhe pas referendumit të vitit 1998, për shkak të mospranimit të rezultatit. Vitet e fundme është rishfaqur hapur ndërhyrja në pushtetet e pavarura, kontrolli i tyre, kufizimi i autonomisë vendore, ndalimi i autoritetit të deleguar dhe i autopërgjegjësisë.

Rruga historike që ka përshkruar shteti shqiptar që prej themelimit deri më sot, sikurse u vërejt, është inkohente, e paqendrueshme, me shumë paqartësi, e mbushur me ekuivoqe dhe të fshehta. Në gjysmën e parë të shekullit të 20-të, me pak përjashtime, ka sunduar forma mbretërore e sundimit. Kjo formë është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë (1925-1939); në mënyrë të tërthortë (1912-1914, 1914-1915); ose në mënyrë të pashpallur (1925-1928). Në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, deri në ndryshimet politike të vitit 1991, forma monarkike e sundimit u ndalua, por republikanizmi nuk u zhvillua. Tradita përcaktoi luhatje të tjera në lidhje me formën e qeverisjes edhe pas vitit 1991. Sikurse u konstatua gjatë parashtrimit të kësaj trajtese, përveç një vullneti ndërkombëtar, të deklaruar apo të padeklaruar, paqendrueshmëria e sistemit politik në Shqipëri është kushtëzuar edhe nga cilësi e komplekse etnotipike shqiptare, si protagonizmi, autoritarizmi, autokracia.

Paqendrueshmëria në lidhje me sistemin politik është shprehje e një vetëdijeje shtetërore të paformuar, po aq sa edhe shprehje e traditës së kufizuar të vetëqeverisjes.

Në luhatjet, ndërprerjet, tronditjet dhe përmbysjet karakter politik, që kanë të bëjnë me sistemin shoqëror, kanë luajtur rol të dukshëm luftërat lokale dhe botërore, konfliktet e brendshme dhe të jashtme; si dhe rendet botërorë të vendosur në konferencat ndërkombëtare të paqeve. Totalitarizmi i periudhës komuniste, që formalisht mbështetej mbi “qeverisjen autentike të popullit”, domethënë mbi idealin “res publicae” të shpallur qysh në antikitetin greko-romak, ishte një dukuri botërore, që gjeti terrenin e përshtatshëm në Shqipëri, ku dhe sundoi më gjatë.

⁶⁹. “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (projekt), Tiranë 1994.

Paqendrueshmëria e sistemit politik në Shqipëri është një dukuri e rishfaqur edhe në periudhën pas vitit 1991. Ajo shprehet në formën e krizës kushtetuese, të krizës institucionale, të krizës së qeverisjes dhe përgjithësisht në mosfunksionimin e strategjive që ngrihen mbi rotacionin dhe përkohshmërinë e qeverisjes. Gjatë afro një shekulli jetë Shqipëria ka ndryshuar mbi 10 herë Kushtetutë (statut), duke përfshirë tri herë periudhën e re (pas ndryshimeve politike). Mungesa e garancive kushtetuese është një prej shprehjeve të drejtpëdrejta të kësaj paqendrueshmërie.

Në historinë botërore ndarja me të shkuarën monarkike; shndërrimi i monarkive asolute në monarki kushtetuese dhe së fundmi kufizimi tërësor i pushtetit monarkik duke e reduktuar vetëm në aspekte protokollare ka ndodhur përgjatë një procesi që nis në mesin e shekullit të 17-të. Monarkia në Shqipëri ishte më e vonuara në shkallë europiane. Retardancat që shfaqen herë pas here edhe në kohën e sotme shprehin papjekurinë e një vullneti popullor plebishitar për t'u ndarë nga e kaluara. Kjo nxitet edhe nga faktorë të tjerë, si qendrimi ndaj pronës e qendrimi ndaj pushtetit.

Opozicioni “republikanizëm-monarkizëm”, ndryshe prej shumë opozicionesh të tjera (të majtë - të djathtë; popullorë - pasanikë; komunistë - reaksionarë; demokratë - socialistë), është thujtë krejtësisht i pastudiuar. Kjo mungesë përbën një përgjegjësi të pakryer të shkencës ndaj qeverisjes.

Pikërisht ky rrotullim e alternim i çuditshëm i formave kontradiktore të qeverimit; është një prej shkaqeve jo vetëm të mosmarrëveshjeve shkencore dhe politike për vlerësimin e së shkuarës, jo vetëm të varfërimit të historisë politike të vendit, por dhe të paqendrueshmërisë së sistemit politik në vend dhe të zgjatjes së tranzicionit.